

L I G J
Nr.9181, datë 5.2.2004

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7943, DATË 1.6.1995 "PËR
PENSIONET SUPLEMENTARE DHE INSTITUTET PRIVATE TË PENSIONEVE",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8393, DATË 20.9.1998**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve", ndryshuar me ligjin nr.8393, datë 20.9.1998, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 7 shtohen pikat 7/1 dhe 7/2 me këtë përmbajtje:

"7/1. Me termin "Institut pensionesh i profesioneve të vështira" kuptohet një institucion financiar, që siguron pensione suplementare dhe përfitime të tjera për punonjësit e një dege të caktuar të ekonomisë, në këmbim të kontributeve të paguara sipas këtij ligji.

7/2. Me termin "Degë e vështirë e ekonomisë" kuptohet ajo degë ku kryhen punë, të cilat, për vështirësinë që paraqesin, janë kategorizuar si punë të kategorisë së parë dhe të dytë, për efekt përfitim pensioni nga sigurimet shoqërore."

2. Në pikën 8 fjalia e dytë shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 4 të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) Nga punëdhënësit e së njëjtës degë të vështirë të ekonomisë, për të punësuarit e punëdhënësit, të cilët e themelojnë ose i bashkëngjiten atij."

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Instituti i pensioneve të profesioneve të vështira është i mbyllur vetëm për të punësuarit e punëdhënësve të një dege të caktuar të ekonomisë."

Neni 3

Në nenin 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Punëdhënësit e degëve të vështira të ekonomisë që kanë krijuar institut pensionesh të profesioneve të vështira ose i janë bashkëngjitur atij, marrin pjesë në fondin e institutit, pavarësisht nga marrëveshja me personat e siguruar."

Neni 4

Në nenin 10, paragrafi i fundit riformulohet si më poshtë:

"Personi i siguruar nuk ka të drejtë t'i transferojë kontributet në një institut tjetër pensionesh kur:

a) ka plotësuar kushtet për pension suplementar;

b) është siguruar në një institut pensionesh të profesioneve të vështira dhe nuk e ka ndërruar punëdhënësin."

Neni 5

Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Punëdhënësi privat i një dege të vështirë të ekonomisë, me jo më pak se 300 persona të punësuar, ka të drejtë të krijojë një institut privat pensionesh të profesioneve të vështira. Kur instituti privat i pensioneve të profesioneve të vështira krijohet nga më shumë se një punëdhënës, duhet që njëri prej tyre të ketë të punësuar më shumë se 100 persona dhe të gjithë së bashku të kenë të punësuar jo më pak se 300 persona."

Neni 6

Në nenin 27, shkronja "b" e pikës 4 riformulohet si më poshtë:

"b) detyrimet e të punësuarve dhe të punëdhënësve për të paguar kontribute."

Neni 7

Në nenin 29, fjalia e parë dhe e dytë e pikës 2 zëvendësohen me fjalitë e mëposhtme:

"Punëdhënësi është i detyruar të paguajë në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira një kontribut në masën jo më pak se 50 për qind të totalit të kontributit për pjesëmarrje në fond. Kontributet në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira paguhen nga i siguruari e punëdhënësi dhe derdhen nga punëdhënësi."

Neni 8

Në nenin 36, pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

"2/1. Institutet e pensioneve të profesioneve të vështira janë të detyruara:

a) të njoftojnë me shkrim, të paktën një herë në vit, pjesëmarrësit në institut për nivelin e të gjitha të ardhurave të regjistruara për përfitimet e tyre. Ky njoftim duhet të përfshijë bilancin financiar dhe të dhëna për administrimin e institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, personelin e bordit drejtues dhe të këshillit mbikëqyrës, numrin e pjesëmarrësve në institut, si dhe ndryshimet në rregulloren e pensioneve, transferimin e fondeve etj.;

b) të dërgojnë me shkrim të dhëna për nivelin e të ardhurave, të regjistruara në llogarinë e pjesëmarrësit për përfitimin që i takon.

2/2. Rregullorja e pensioneve, të dhënat për administrimin e institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, për personelin e bordit drejtues dhe këshillin mbikëqyrës, për numrin e pjesëmarrësve, përfshirë edhe të gjitha ndryshimet në njoftimin e mësipërm, duhet të publikohen në zyrën ku është regjistruar instituti. Këto të dhëna duhet të jenë të vlefshme për të gjithë pjesëmarrësit në institutin e pensioneve të profesioneve të vështira."

Neni 9

Në nenin 37, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Një institut pensionesh i profesioneve të vështira është i detyruar të krijojë fond rezervë për mbulimin e humbjeve dhe për garantimin e pagesës së përfitimeve, i cili të mbulojë të paktën tre muaj shpenzime për përfitime.

Fondi rezervë për mbulimin e humbjeve krijohet nga fitimi i institutit të pensioneve të profesioneve të vështira, si rezultat i investimeve të tij.

Në rast se investimi i institutit të pensioneve të profesioneve të vështira rezulton me humbje dhe fondi rezervë, si dhe çdo fond tjetër i krijuar nga fitimi, janë të pamjaftueshëm për mbulimin e humbjeve, humbjet mbulohen prej të ardhurave të mbledhura në institut për përfitimet e pjesëmarrësve. Humbjet mund të mbulohen edhe me një kredi pa interes ose kredi të garantuara nga punëdhënësi."

Neni 10

Në nenin 38, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

"8. Një institut pensionesh i profesioneve të vështira është i detyruar të arrijë një nivel minimal fitimi, të barabartë me normën e interesit të konsoliduar të sistemit bankar."

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4158, datë 2.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**